

R E L A C I O N

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9723, DATË 3.5.2007, “PËR REGJISTRIMIN E BIZNESIT”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të komitetit të ekspertëve për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (*MONEYVAL*) të Këshillit të Evropës, dhe me qëllim rritjen e mëtejshme të transparencës lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, u identifikuan ndryshimet ligjore që duheshin bërë në ligjin nr.9723, datë 3.5.2007, “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar, të cilat do të mundësojnë rritjen e mëtejshme të transparencës lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik.

Gjithashtu, me anë të këtij projektligji bëhen edhe disa ndryshime të tjera në ligj për sa i përket subjekteve që detyrohen të regjistrohen në regjistrin tregtar dhe personat që lejohen të bëjnë aplikimin për regjistrimin fillestar të personave juridikë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij projektligji nuk është i planifikuar, në programin analitik të projekt akteve të Këshillit të Ministrave.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Në përfundim të procesit të vlerësimit të Shqipërisë nga Komiteti i *MONEYVAL*-it, lidhur me masat e marra nga vendi ynë kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, Komiteti ka lënë disa rekomandime, që duhen përmbushur nga Shqipëria.

Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të komitetit të ekspertëve për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit

(MONEYVAL) të Këshillit të Evropës, dhe me qëllim rritjen e mëtejshme të transparencës lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, është hartuar ky projektligj, i cili mundëson rritjen e mëtejshme të transparencës lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik.

Me anë të këtij projektligji parashikohet se aplikimi për ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu, në këtë projektligj është parashikuar se moskryerja e detyrimit për regjistrimin e ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë.

Ndërkohë, për shoqëritë aksionare mosplotësimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 43, të këtij ligji, ku përcaktohet se: “shoqëria aksionare nuk detyrohet të njoftojë çdo transferim të aksioneve. Shoqëria, së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit njofton listën e plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet nominative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj”, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI, VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk përafron asnjë akt komunitar dhe nuk lidhet me zbatimin e ndonjë *acquis* specifik të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me anë të këtij projektligji parashikohet që aplikimi për ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik bëhet brenda 30 ditëve

kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu, në këtë projektligj është parashikuar se moskryerja e detyrimit për regjistrimin e ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë.

Ndërkohë, me qëllim mospengimin e çdo aksioneri të interesuar të shoqërisë aksionare për të regjistruar çdo transferim të aksioneve nominative, por edhe me qëllim rritjen e transparencës së mëtejshme lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, nuk është bërë shfuqizimi i shkronjës “b”, të nenit 44, të ligjit ekzistues, por, në këtë projektligj është parashikuar që për shoqëritë aksionare mosplotësimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 43, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë.

Më konkretisht:

Në nenin 1, të këtij projektligji, parashikohet që në nenin 22, të ligjit ekzistues, pas pikës 4 të shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje: “4/1. Aplikimi për ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji .”

Në nenin 2, të këtij projektligji, parashikohet ndryshimi i pikës 3, të nenit 26, të ligjit, “3. Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht, nga të gjithë themeluesit ose nga administrator i shoqërisë, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike, me të cilat lidhen pjesëmarrjet, kuotat apo aksionet, mund të kryhen, gjithashtu, dhe nga anëtari, ortaku apo aksionari, të cilit këto i përkasin, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre.”

Në nenin 3, të këtij projektligji parashikohet që në nenin 74, të ligjit ekzistues pas pikës 3 të shtohen pikat 3/1 dhe 3/2, me këtë përmbajtje: “3/1. Moskryerja e detyrimit për regjistrimin e ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës

faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, 100 000 lekë; dhe 3/2. Për shoqëritë aksionare, mosplotësimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 43, të këtij ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë.”

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra Kombëtare e Biznesit për marrjen e masave për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare.

KËSHILLI I MINISTRAVE